LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJIT

RAPORTI TREMUJOR 2

FORUM PËR TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS METODOLOGJISË SË KAFESË BOTËRORE

RRJETI LUFTOHET ME RRJET – TAKIME PAS PUNE KUNDËR KORRUPSIONIT

PËRMIRËSIMI I PROCEDURAVE DICIPLINORE PËR PROKURORËT PUBLIKË

TRAJTIMI I FËMIJËVE TË RRUGËS DHE FËMIJËVE QË LYPIN DUKE MBËSHTETUR FAMILJET

EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

MAJ 2024

KLAUZOLË PËRJASHTIMI:
KY RAPORT ËSHTË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA E TIJ ËSHTË PËRGJEGJËSI E VETME E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT - INSTITUTI I TË DREJTAVE THEMELORE DHE TË NJERIUT (LBI-GMR) DHE NUK PASQYRON DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Dieter SCHINDLAUER

Drejtues ekipi, "Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit"

"Ne shfrytëzojmë këtë botim për të ruajtur një frymë të mirë dhe për të mbështetur një etikë besimi në arsyen e mirë për ndryshim, reformë dhe një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për ta bërë këtë, ne do të tregojmë hapat përpara në mënyrë të tillë që ata të mos humbasin në mesin e zhurmës mbizotëruese të lajmeve zhgënjyese".

I dashur lexues,

në raportin tonë të tremujorit të tretë kemi mbledhur edhe një herë lajmet e bukura nga fushat e ndryshme të sundimit të ligjit që trajtohen brenda projektit që po realizojmë. Në këtë numër do të gjeni pikat kryesore që ia vlen të lexohen për tu mbushur me shpresë dhe për të kuptuar qasjet e drejta që manifestohen gjatë punës.
Mund të mësoni mbi hapat që janë ndërmarrë për të shqyrtuar procedurat diciplinore për prokurorët; hapat e mëtejshëm për të zbatuar rekomandimet e Misionit të BE-së për recension nga kolegët në kuadër të Këshillit Gjyqësor dhe një intervistë me Udhëheqësin e Komponetit Grzegorz Borkowski, ku ai ndan edhe përvojën e tij personale me mbajtjen e qëndrimit të drejtë ndaj paanshmërisë dhe pavarësisë të gjyqësorit në Poloni. Veç kësaj, mund të lexoni mbi këmbimin e suksesshëm të njohurive nga Sllovenia për luftën kundër korrupsionit nga ana e policisë dhe në operacionet ndërkufitare si dhe të frymëzoheni nga takimet joformale pas pune kundërkorrupsionit që organizohen nga komponenti ynë i palodhshëm anti-korrupsion.

PARATHËNIE

Gjatë kësaj periudhe raportimi u mbajt Forumi i parë për të Drejtat e Njeriut, një ngjarje ku ofrohet informacion mbi ndryshimet që duhen bërë në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe që u zhvillua sipas metodës të ashtuquajtur ,,Kafeja Botërore'' (World Café).

Projekti mbajti edhe një ngjarje mbi çështjet që lidhen me diskriminimin ndërseksional të grave dhe vajzave rome dhe, bashkë me Zyrën e Avokatit të Popullit shënoi Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve të Rrugës me një diskutim të frytshëm në një qendër kujdesit ditor për fëmijët e rrugës mbi problemet e përditshme me të cilat ballafaqohen këta fëmijë dhe prindërit e tyre.

Në fund, mund të lexoni diçka mbi takimin tonë të dytë të Bordit Udhëheqës që u mbajt me sukses, me komunikim dhe angazhim të mirëfilltë me partnerët tanë në vend duke i dhënë dritë të gjelbër një plani të ri pune që nuk duket i lehtë por për të cilin ia vlen të punohet.



Dieter Schindlauer
Drejtues ekipi

JU PARAQESIM:

FORUMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Forumi i parë për të Drejtat e Njeriut që u mbajt ne 26 mars 2024 shënoi fillimin e një tradite të përvitshme – ngjarje me pjesëmarrje të të gjitha palëve lehtësuar nga projekti i BE-së për Sundim të Ligjit, i projektuar ekskluzivisht për Institucionet Përfituese që merren me çështjet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE TË RRUGËS

Projekti shfrytëzoi këtë rast për të theksuar rëndësinë e mjediseve të familjeve të shëndosha dhe kujdesit të mirë prindëror për të parandaluar dhe për të trajtuar problemin e fëmijëve të rrugës.

KËSHILLI GJYQËSOR: RISHQYRTIMI I AKTEVE NËNLIGJORE

Këshilli Gjyqësor Republikës së Maqedonisë së Veriut me mbështetje të projektit ndërmori një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të integritetit gjyqësor dhe veprimit transparent duke bërë plotësim dhe ndryshim të akteve nënligjore.

Të flasim pak për...

- Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit: Arritjet kryesore dhe planet e të ardhmes prezantohen në takimin e dytë të Bordit Udhëheqës
- KSHPK forcon infrastrukturën digjitale dhe sigurinë përmes politikës për menaxhim të qasjes së përdoruesit
- Transparenca dhe edukimi si elemente thelbësore në luftën kundër korrupsionit sistemor në Maqedoninë e Veriut
- Metodologjia inovative ,,Kafeja Botërore'' (World Café) lehtëson dialogun bashkëpunues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- Katalizatorët e Ndryshimit – Angazhimi i forcave të rendit për të luftuar korrupsionin në Maqedoninë e Veriut
- Trajtimi i fëmijëve të rrugës përmes mbështetjes së familjes
- Forcimi i llogaridhënies me rritje të procedurave diciplinore për prokurorët publikë
- Rrjetet luftohen me Rrjete – Takime pas pune kundër korrupsionit
- Avancimi i rekomandimeve nga Raporti i Misionit të BE-së për recension kolegësh: rishqyrtim i akteve nënligjore për rritje të efikasitetit të Këshhillit Gjyqësor
- Dialog mbi diskriminimin ndërseksional dhe qasjen në drejtësi për gratë dhe vajzat rome

Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit: Arritjet kryesore dhe planet për të ardhmen prezantohen gjatë takimit të dytë të Bordit Udhëheqës

Projekti ,,Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit'' mbajti së fundmi takimin e dytë të bordit udhëheqës, një arritje e rëndësishme në angazhimet e vazhdueshme për të avancuar drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në Maqedoninë e Veriut. Ky takim u mbajt në datë 21 mars 2024 në hapësirat e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe për ekipin e projektit ishte një platformë e mirë për të shpalosur pikat kryesore të Raportit të Progresit që mbulon periudhën nga shtatori 2023 deri në shkurt 2024, si dhe për të theksuar edhe aktivitetet që planifikohen për të ardhmen.

Udhëheqësja e aktivitetit, **Znj. Marzia Palota** nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoninë e Veriut iu dëshiroi mirëseardhjen pjesëmarrësve duke theksuar mundësinë e madhe që i jepet Maqedonisë së Veriut për të përparuar në fushat e drejtësisë, të drejtave të njeriut, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes aktiviteteve që ofron Projekti.

Znj. Agnes Taibl, Udhëheqëse e Projektit theksoi që ndjehej krenare me arritjet e deritanishme të realizuara bashkarisht, ashtu siç dëshmojnë edhe rezultatet dhe arritjet e dokumentuara në Raportin e Parë Përshkrues.







Në këtë drejtim, Znj. Taibl nënvizoi bashkëpunimin profesional mes ekspertëve të projektit dhe institucioneve partnere në vend si thelbësore për suksesin e projektit në të gjitha komponentet. Që nga fillimi i projektit, ekspertët kanë bashkëpunuar me partnerët e vendit për të ndërtuar relacione të forta dhe gjatë punës së përditshme që i mundëson ekipit të projektit të përshtasë aktivitetet e projektit nevojave që imponon realiteti i Maqedonisë së Veriut, duke siguruar kështu që aktivitetet të jenë efektive dhe të qëndrueshme.



Prezantimet e Udhëheqësve të Komponenteve ngjallën diskutime konstruktive me përfaqësuesit e institucioneve përfituese, që shprehën falenderimin e tyre për ndihmën që ofron Projekti dhe kontributet me vlerë në fushën e sundimit të ligjit.

Znj. Vesna Dameva, Kryetare e Këshilli Gjyqësor, theksoi progresin e madh që është bërë gjatë muajve të fundit si rezultat i dedikimit që kanë treguar ekspertët e Komponentit 1, që me shumë gjasa do i paraprijnë rezultateve që priten.

Z. Sasho Jovanovski, Udhëheqës i Njësisë kundër Korrupsionit në Ministrinë e Brendshme, i shprehu falenderime Robert Splajtit, Udhëheqës Komponente, si dhe projektit në përgjithësi për lidershipin në hetimet e parandalimit të krimit, duke paraparë sukses edhe në periudhën tre-vjeçare që pason.

Duke trajtuar nevojën për mbështetje, **Z. Besnik Xhemaili** nga Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur cilësinë e sitemit në fushat e antikorrupsionit.

Znj.Gordana Trenkoska, Zëvendës-udhëheqëse sektori nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, theksoi që Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve përbën themelin e zbatimit të aktiviteteve që lidhen me fëmijet, duke nënvizuar rëndësinë e madhe që ka edhe forcimi i kornizave kundër diskriminimit në mënyrë që të mundësohet analiza e rasteve të diskriminimit në fusha të caktuara.

Znj. Dijana Gjerovska, Udhëheqëse e Njësisë për Mbikëqyrje të Ekzekutimit të Masave të Provës pranë Drejtorisë së Ekzekutimit të Sanksioneve theksoi rezultatet e prekshme që janë arritur pas diskutimeve mbi sanksionet alternative, duke nënvizuar rritjen e dukshme të rasteve aktive të provës si ndryshime pozitive në implementim, gjë që është shenjë e ndikimit pozitiv që ka bashkëpunimi efektiv.

Në takim morën pjese 42 përfaqësues nga delegacioni i BE-së, partnerët e konsorciumit, institucionet përfituese dhe ekspertë, gjë që dëshmon angazhimet për bashkëpunim drejt një shoqërie më të drejtë dhe më transparente në Maqedoninë e Veriut.

Në të ardhmen Projekti do të vazhdojë të mbështesë institucionet përfituese duke hartuar strategji, duke zhvilluar fushata për rritjen e vetëdijes, punëtori, trajnime dhe iniciativa për rritje të kapaciteteve gjatë gjashtë muajve që vijojnë.





Kapja e suksesit:

Festë vizuele















KSHPK-ja forcon infrastrukturën dhe sigurinë dixhitale përmes politikës së menaxhimit të qasjes së përdoruesve

Së fundmi, KSHPK ka bërë ndryshime të rëndësishme transformuese duke zgjeruar kompleksitetin e aktiviteteve dhe operacioneve. Në vitin 2021, KSHPK shënoi një arritje duke u zhvendosur në ndërtesë tjetër, një kalim ky që ofroi mundësi për tu rritur numri i stafit dhe për tu bërë një holl serveri me mundësi për infrastrukturë më të mirë të teknologjisë informatike.


KSHPK filloi rrugën e digjitalizimit për të qenë në hap me kohën dhe me mjedisin që sjell epoka digjitale. Një numër i madh i mjeteve të teknologjisë informatike dhe zgjidhjeve u zhvilluan dhe zbatuan për të forcuar efikasitetin e operacioneve. Këto zgjidhje teknologjike luajtën rol të rëndësishëm në rritjen e cilsësisë së punës tek një numër i madh i ekipeve brenda KSHPK.



Që nga fillimi i projektit, ishte e qartë që ekziston nevoja për kontroll të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së softuerit dhe harduerit. Prandaj, Komponenti 3 e ka në fokus mbështetjen e KSHPK për tu siguruar menaxhim i drejtë i kontrollit të brendshëm të mjeteve të teknologjive dhe zgjidhjeve informatike për të rritur sigurinë e informacionit.

Që nga nëntori, Komponenti 3 bashkëpunoi me ekipin e IT-së brenda KSHPK për të siguruar menaxhim të drejtë të qasjes tek të gjitha zgjidhjet e teknologjisë informatike duke ofruar metodologji dhe mbështetje brenda vendit të punës përmes një kontrolli gjithëpërfshirës të të drejtave për qasje për çdo të punësuar brenda KSHPK. Ky kontroll i kujdesshëm ndriçoi zbrazëtirat dhe problemet e rëndësishme që u trajtuan menjëherë përmes aktiviteteve përmirësuese gjatë vetë procesit.

Një rezultat i rëndësishëm që doli nga kjo punë ishte nevoja për të hartuar ,,Politikën e menaxhimit të qasjes së përdoruesit'' për tu siguruar qëndrueshmëria e progresit të arritur përmes punës së zhvilluar me mbështetjen e këtij Komponenti. Kjo politikë do të shërbejë si kornizë e brendshme rregullatore për të dhënë dhe për të marrë të drejtën e të punësuarve për tu qasur tek mjetet e teknologjisë informatike dhe zgjidhjet informatike për çdo të punësuar në KSHPK në të ardhmen. Kjo qasje proaktive siguron mjedis më të sigurt dhe efikas digjital për operacionet momentale dhe të ardhme të KSHPK-së.



Transparenca dhe edukimi si elementet thelbësore në luftën kundër korrupsionit sistemor në Maqedoninë e Veriut

Në datë 23 prill 2024 në hapësirat e Bankës NLB në Shkup u mbajt një ligjeratë e rëndësishme me titull ,,Ballafaqimi me ekonomi me korrupsion sistemor''. Kjo ngjarje u mbajt si pjesë e projektit të BE-së për mbeshtetje të sundimit të ligjit në bashkëpunim me Ambasadën e Sllovenisë dhe Shoqatës së Sipërmarrësve Sllovenë dhe Maqedonas.

Magjistre Mojca Kuzmicki, eksperte e luftës kundër korrupsionit dhe larjes së parave dhe **Dr. David Smolej,** ekspert i masave kundër korrupsionit ndanë përvojat e tyre praktike për luftën kundër korrupsionit me përfaqësuesit e sektorit të biznesit në Maqedoninë e Veriut.



Në këtë ligjeratë u theksuan disa pika të rëndësishme. Së pari, u nënvizua rëndësia e luftës kundër korrupsionit për ruajtjen e transparencës dhe drejtësisë, si në strukturat qeverisëse ashtu edhe në sektorin privat. U diskutua mbi atë se si korrupsioni mund të lëndojë institucionet demokratike dhe të pengojë përparimin ekonomik.

Poashtu u prezantuan edhe strategjitë efektive në luftën kundër korrupsionit. Te këto strategji bën pjesë edhe forcimi i kornizës ligjore, krijimi i organeve të pavarura mbikëqyrëse, dhe angazhimi i shoqërisë civile në këtë proces.

Veç kësaj u theksua edhe rëndësia që ka bashkëpunimi ndërkombëtar. Zbatimi i marrëveshjeve dhe konventave që mundësojnë bashkëpunim gjyqësor ndërkufitar dhe këmbimi i informacioneve të rëndësishme u nënvizuan si hapa thelbësorë në parandalimin e korrupsionit në nivel ndërkufitar.

Si i fundit por jo më pak i rëndësishëm, u diskutua edhe roli që arsimimi ka në rritjen e vetëdijes mbi ndikimet negative të korrupsionit dhe promovimi i sjelljes etike. Edukimi i opinionit mbi efektet negative të korrupsionit shihet si element thelbësor për aktivitetet kundër korrupsionit.

Marrë në përgjithësi, me këtë ligjeratë u dha njohuri e madhe mbi kompleksitetin e luftës kundër korrupsionit sistemor dhe u theksua rëndësia e angazhimeve bashkëpunuese si në nivel nacional, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.




REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF THE INTERIOR
JUDICIARY
POLICE
ANTI-CORR

Metodologjia me inovacion ,,World Café'' (Kafeja botërore) mundëson dialog bashkëpunues për çështjet e të drejtave të njeriut

Me Forumin e parë për të Drejtat e Njeriut që u mbajt në 26 mars të vitit 2024 u shënua fillimi i një tradite të përvitshme – ngjarje me pjesëmarrje të çdo pale relevante që lehtësohet nga projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit, e përshtatur ekskluzivisht për Institucionet Përfituese që trajtojnë çështjet e të drejtave të njeriut.

Qëllimi që synohet me këtë forum është i qartë: me bashkëpunim të bëhet identifikimi i sfidave dhe përmirësimeve që duhen bërë brenda sistemit për mbrojtje të të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut. Afër tridhjetë palë relevante - secila me përvojën dhe ekspertizën e saj u mblodhën bashkë për të ndarë njohuri dhe informacion, duke nxitur kështu një këmbim të pasur idesh.



Në këtë takim iu dha shumë rëndësi përdorimit të metodologjisë për pjesëmarrje e njohur si Kafeja Botërorë (World Café). Kjo qasje që u zgjodh për shkak të kapacitetit që ka për të nxitur dialog të hapur dhe bashkëpunim siguroi platformën që u mundëson palëve relevante të angazhohen me njëra tjetrën.

Takimi u mundësua nga **Karin Bischof**, eksperte në fushën e monitorimit, vlerësimit dhe metodave të trajnimit me pjesëmarrje dhe **Natasha Boshkova,** eksperte për edukimin për të drejtat e njeriut, të dyja pjesë e projektit: Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit.

Ç’është ajo që e bën të veçantë metodologjinë e ashtuquajtur Kafeja Botërore (World Café)?

Kjo metodologji ka të bëjë me përfshirjen e të gjithve. Kjo qasje që ka ne fokus bashkëpunimin siguron që çdo palë relevante që merr pjesë në takim të ketë mundësinë për t’iu dëgjuar zëri dhe për tu vlerësuar. Njohuritë kolektive u vendosën në dispozicion përmes disa raundeve të diskutimeve që u udhëhoqën nga pyetjet e përbashkëta. Kjo metodë parasheh këmbimin e ideve në grupe të vogla, si dhe këmbimin e ideve duke ndërruar grupet nëpër tavolina. Ky rotacion i pjesëmarrësve nga një grup pune në tjetrin siguron që njohuritë nga njëra tavolinë të lidhen me idetë e grupeve që punojnë nëpër tavolinat e tjera.

Një nevojë që theksohet nga palët momentale me interes për të rritur sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut është hartimi i udhëzimeve praktike për të forcuar bashkëpunimin strategjik mes institucioneve. Për këtë arsye planifikohen edhe ngjarje të tjera për rrjetëzim siç është Kafeja Botërore (World Café).

Rekomandimet e dhëna gjatë raundeve të diskutimit në forum po konsolidohen në një raport gjithëpërfshirës.





METODOLOGJIA ,,KAFEJA BOTËRORE'':

"Diskutimet më të frytshme zhvillohen gjatë pushimit të kafesë!"

Kafeja Botërore (World Café) ndërtohet mbi përvojën që thotë që bisedat më të frytshme – si për shembull gjatë konferencave – zhvillohen gjatë pushimeve të kafesë.
Metoda e Kafesë Botërore thjesht përpiqet të imitojë një pushim kafeje të zgjatur (por të strukturuar).

Përfitimi që vjen nga Kafeja Botërore është që palëve me interes iu ofrohet kohë dhe hapësirë për:

- bashkëveprim dhe rrjetëzim me njëri tjetrin,
- angazhim mbi tema të caktuara dhe kontribut me përvojat/njohuritë/ shqëtësimet e tyre,
- diskutim i hollësishëm mbi diçka që ka rëndësi për ta,
- zbulimi i zgjidhjeve/ideve/veprimeve,
- gjetja e përgjigjeve për çështje, tema apo probleme të komplikuara dhe komplekse që një (!) person i vetëm nuk mund t'i zgjidhë vetë ngaqë duhet përvojë, njohuri dhe zgjuarsi kolektive e një grupi të tërë.



Për tu realizuar Kafeja Botërore duhet moderator, pjesëmarrës, një hapësirë me shumë tavolina dhe karrige, kafe dhe (më e rëndësishmja):

- një qëllim i qartë
- temë që është me rëndësi për audiencën (në punën dhe/apo jetën e tyre)
- një sërë pyetjesh interesante, që kërkojnë angazhim, dhe që kanë kompleksitet të mjaftueshëm për të inicuar biseda të rëndësishme. Pyetjet me vend nuk është patjetër që të implikojnë veprime të menjëhershme apo mënyra për tu zgjidhur problemet. Ato thjesht duhet të nxisin debat dhe kurreshtje.



Për më shumë të dhëna dhe udhëzime, shih:

https://theworldcafe.com/key-concepts-resources/world-cafe-method/

Katalizatorët e ndryshimeve – Qëndrim i vendosur i organeve të rendit për të luftuar korrupsionin në Maqedoninë e Veriut

Projekti i BE-së ,,Mbështetje për sundimin e ligjit'' në Maqedoninë e Veriut organizoi ngjarjen me titull ,,Katalizatorët e ndryshimeve'', për forcim të angazhimeve që sundimi i ligjit merr për të luftuar korrupsionin. Në këtë ngjarje u ndanë praktikat më të mira dhe strategjitë me inovacion nga praktika policore e Sllovenisë, me qëllim që në politikat e Maqedonisë së Veriut kundër korrupsionit të inicohen ndryshime. Pjesëmarrësit në këtë ngjarje analizuan modelet e suksesshme nga vende të tjera të BE-së, që ua ka bërë atyre të mundur zhvillimin e mekanizmave precize kundër korrupsionit që i përshtaten kornizave ligjore dhe shoqërore të vendeve të tyre. Në këtë ngjarje poashtu u theksua rëndësia që ka bashkëpunimi ndërkufitar në luftën kundër korrupsionit, duke nënvizuar nevojën për qasje të koordinuara përtej kufinjve të shteteve.

Ngjarja filloi me fjalën e mirëseardhjes nga **Znj. Mojca Kuzmicki** me çka filloi agjenda e ditës por edhe me theksimin e qasjes kolektive ne luftën kundër korrupsionit. Pastaj pasoi prezantim i shkëlqyer nga **Z. David Smolej,** doktor shkencash që prezantoi "Aspektet ligjore dhe organizative në luftën kundër korrupsionit në Sllloveni dhe BE." Prezantimi i tij përmbante kornizë krahasuese që tregonte se si Sllovenia ka avancuar mekanizmat ligjore për të luftuar korrupsionin me sukses, duke ofruar kështu përvojë që Maqedonia e Veriut mund ta përdorë.



Në vazhdim, **Z. Matjaz Jerkic,** magjistër, mbajti prezantim me titull "Si përdoren masat e fshehta hetuese në hetime të veprave korruptive në Slloveni." Në këtë session që u nda në dy pjesë, ai foli për hollësitë e operacioneve të fshehura, duke prezantuar teknikat e sofistikuara hetuese që janë shumë të rëndësishme për aktivitetet kundër korrupsionit.

Prezantimet e pasdites:
Pas pushimit të dytë, Znj. Lidija Raiceviç, doktore shkencash, prokurore publike nga Shkupi, foli për kornizën ligjore në Maqedoninë e Veriut që trajton korrupsionin. Prezantimi i saj me titull ,,Ligjet që trajtojnë fushën e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut – Cilat janë ndryshimet e nevojshme," theksoi si arritjet ashtu edhe zbrazëtirat e kornizës së tashme ligjore. Ajo foli për reformat e posaçme që duhen duke u frymëzuar nga modelet e suksesshme të BE-së, duke nxitur kështu një diskutim të kujdesshëm mbi hapat praktike që duhet ndjekur në të ardhmen.

Përfundimet dhe këmbimi i kontakteve:
Ngjarja përfundoi me sesionin përmbyllës ku u ritheksuan gjetjet dhe rezultatet kryesore. Gjatë pjesës ku palët me interes këmbyen kontaktet ata edhe diskutuan mbi bashkëpunimet e mundshme, por edhe ndanë strategjitë për një të ardhme pa korrupsion.

Ndikimi dhe hapat e radhës:
Ngjarja me titull ,,Katalizatorët e ndryshimit'' ishte një arritje e rëndësishme për angazhimet që Ngjarja ,,Katalizatorët e Ndryshimeve'' shënoi një arritje të rëndësishme në përpjekjet që Maqedonia e Veriut bën për të rritur qeverisjen e drejtë dhe transparencën. Me mbështetje të vazhdueshme nga BE-ja, Maqedonia e Veriut ka më shumë mundësi për të hartuar kornizë efektive kundër korrupsionit.





Trajtimi i fëmijëve të rrugës dhe fëmijëve që lypin duke mbështetur familjet

Çdo vit në **12 prill, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve të Rrugës** ngrihet zëri për fëmijët e rrugës në mënyrë që të mos anashkalohen të drejtat e tyre. Këtë vit, projekti i BE-së ,,Mbështetja e sundimit të ligjit'' shfrytëzoi këtë datë për të theksuar rëndësinë që ka familja e shëndoshë dhe kujdesi i drejtë prindëror për parandalim dhe për trajtim të problemit të fëmijëve të rrugës.

Mbi 40 përfaqësues të organeve relevante të shtetit, qendrave për kujdes të fëmijëve të rrugës që menaxhohen nga Organizata qytetare (OJQ), dhe prindër dhe kujdestarë të fëmijëve në rrezik morën pjesë në këtë takim për rritje të vetëdijes.



Cili është misioni i tyre? Të ndriçohet roli thelbësor që ka familja e shëndoshë në trajtimin e problemit me fëmijët e rrugës dhe fëmijët që lypin në rrugë.

Organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit (AP), me këtë ngjarje synohet që prindërve dhe kujdestarëve t'iu ofrohet njohuri mbi resurset në dispozicion për të trajtuar sfidat paraprakisht. Në sfondin e Qendrës Ditore për Kujdes të Fëmijëve pjesëmarrësve iu dha mundësia që të ndajnë histori dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje.

VENDET KU MUND TË MARRIN MBËSHTETJE DHE KËSHILLA PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT

- Rrjeti Nacional kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje

Numri pa pagesë për prindërit 075 230 530, ekip i ekspertëve profesionistë ofron mbështetje dhe këshilla për prindërit dhe kujdestarët, çdo ditë punë, nga ora 10:00 deri në orën 16:00

- Ambasada e Fëmijëve MEGJASHI

Linja SOS 02/2 465 316

- Aplikacioni mobil "Bebbo" për të gjithë prindërit dhe këdo që kujdeset për fëmijët e moshës 0 deri 6 vjet.
- Hyrje në prindërim pozitiv (video informuese) - **LINK**
- Këshilla mbi martesën dhe familjen në Qendrat e Punës Sociale
- Shërbimet profesionale nëpër institucionet arsimore

Nga diskutimet u bë e qartë që shumë prindër dhe kujdestarë ballafaqohen me sfida specifike. Disa nga ta folën për pengesat byrokratike, kurse disa theksuan nevojën për mbështetje me gjëra esenciale për familjet e tyre.

Poashtu, disa nga pjesëmarrësit kërkuan mbështetje nga projekti për procedurat e gjata të regjistrimit të fëmijëve që nuk kanë numër amë dhe që nuk kanë akoma çertifikatë lindjeje. Eskpertët ligjorë nga projekti kontaktuan institucionet relevante për të trajtuar këto çështje. U identifikuan dhe u zgjodhën pengesa të caktuara që shkaktojnë vonesa, duke hapur kështu rrugën për progres të mëtejshëm. Ekspertët do të vazhdojnë të monitorojnë rastet deri sa ato të zgjidhen duke siguruar numra amë dhe çertifikata lindjeje për këta fëmijë.

Udhëtimi vazhdon. Dedikimi ynë për të ndihmuar këto familje bëhet gjithmonë më i fortë. Duke punuar së bashku, duke treguar zemërgjerësi dhe duke vepruar bashkë, po i afrohemi qëllimit që kemi për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.





Rritja e llogaridhënies duke forcuar procedurat diciplinore për prokurorët publikë

Mënyra se si veprojnë prokurorët publikë, po edhe gjykatësit, nuk mund t'i lihet vetëm diskrecionit të tyre, qoftë brenda, qoftë jashtë vendit të punës. Kjo është veçanërisht me rëndësi kur bëhet vlerësimi i aktiviteteve të prokurorëve dhe kur merren masa diciplinore kundër tyre.

Është me rëndësi që të sigurohemi që prokurorët japin llogari për sjelljet që bëjnë, por kjo gjë nuk duhet të pengojë pavarësinë e tyre. Për tu arritur kjo barazpeshë, duhet një mekanizëm i qartë për të diciplinuar prokurorët që kanë bërë shkelje serioze të detyrës. Këto mekanizma mund të bazohen në ligj, dhe të realizohen në mënyrë transparente me mbikëqyrje të ndonjë organi të pavarur që nuk ka lidhje me ekzekutivin.

Gjatë viteve të fundit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka ndërmarrë hapa të rëndësishme për të forcuar sistemin diciplinor për prokurorët publikë. Një nga këto hapa ishte edhe miratimi i Ligjit të ri për Zyrën e Prokurorit Publik, që trajton rekomandimet e dhëna nga organet ndërkombëtare. Sipas Raportit të Komisioni Evropian të vitit 2022 për Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet e gjyqësorit kanë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme rregulla të reja për emërim, avancim, diciplinim dhe shkarkim të gjykatësve dhe prokurorëve. Zbatimi i dispozitave të reja ligjore mbi ZPP dhe Rregullorja e Procedurave Diciplinore dëshmoi që ka nevojë për forcim të proceseve të shqyrtimit për të sjellur në jetë rregullativat ekzistuese dhe praktikat e procedurave diciplinore dhe për t'i përafruar ato me standardet evropiane.



Komponenti 1 realizoi vlerësimin ligjor dhe përgatiti raportin mbi procedurat diciplinore që përputhen me standardet evropiane. Gjatë takimeve të vlerësimit u vu re që ka mungesë komunikimi të përditshëm mes palëve kryesore relevante përveç komunikimit formal. Si rezultat i gjithë kësaj, Komponenti 1 organizoi tavolinë të rrumbullakët që ishte takimi i parë i këtij lloji mes Prokurit të Përgjithshëm, anëtarëve të Komisionit Diciplinor dhe anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë.



Gjatë këtij takimi, ekspertët e Komponentit 1 prezantuan Raportin mbi Procedurat Diciplinore. Kjo ngjalli diskutim mbi mënyrën e inkorporimit të rekomandimeve. Prokurori i Përgjithshëm, anëtarët e Komisionit Diciplinor dhe anëtarët e Këshillit të Prokurorëve Publikë ndanë sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të procedurave diciplinore nga pozitat dhe kapacitetet e tyre ligjore.

Si përfundim i përbashkët u vendos që të fillohet procesi për plotësim dhe ndryshim të Rregullores për procedurat diciplinore. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është që të sigurohet etablimi i sigurisë ligjore dhe që procedurat të zbatohen në kohë. Poashtu, qëllimi është që të ofrohet mbrojtje ligjore për prokurorët publikë që janë subjekt i këtyre procedurave.







Rrjeti luftohet me rrjet – Takime pas pune kundër korrupsionit

Për korrupsionin thuhet shpesh që ka të bëjë me paratë dhe me sjelljen që bëjnë vetëm disa individë apo ,,molla të prishura'' që veprojnë brenda një sistemi që funksionon drejtë. Por realiteti nuk është kaq i thjeshtë. Siç dëshmohet edhe me kërkimet e fundit, korrupsioni është një fenomen i rrjetëzuar që funksionon përmes lidhjeve mes lojtarëve të ndryshëm nëpër shtete, besime dhe sektore të ndryshme.



Në maj të vitit 2023 Komisioni Evropian me pakon e BE-së kundër korrupsionit etabloi rrjetin e BE-së kundër korrupsionit që mbajti takimin e parë në shtator të vitit të shkuar duke njohur rrjetëzimin aktiv mes profesionistëve në fushën e anti-korrupsionit si një masë të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit.

Përmes këtij rrjeti synohet që të nxitet bashkëpunimi, identifikimi i tendencave dhe ndërtimi i politikave më efektive kundër korrupsionit në mbarë BE-në. Ky takimi bëri bashkë të gjitha palët relevante për të luftuar korrupsionin, që nga autoritetet e vendit dhe ekspertët e deri tek organizatat ndërkombëtare dhe organet relevante të BE-së në një rrjet. "Rrjeti luftohet me rrjet" tha Komisionerja suedeze Ilva Johanson në fjalën e rastit që hapi takimin e parë të rrjetëzimit.



“Duam të ofrojmë një platformë joformale ku personat që kanë interes për luftën kundër korrupsionit në fusha të ndryshme mund të takohen dhe të këmbejnë ide, plane dhe projekte. Apo thjesht të flasin me njëri tjetrin mbi punën që bëjnë për të ndërtuar kështu relacione të fuqishme profesionale që do të zgjasin gjatë”, tha **Lena Anderson** duke iu përgjigjur pyetjes se pse ky komponent organizon këto Takime Pas Pune Anti-korrupsion. Veç kësaj, lidhjet personale nxisin kultivimin e angazhimit konstruktiv mes autoriteteve të anti-korrupsionit dhe organizatave joqeveritare dhe ne jemi më se të lumtur që në këto takime pamë pjesëmarrës nga të dy palët.”

Megjithatë, kjo ide u prezantua në komponent nga KSHPK, punonjësit e të cilit morën pjesë në çdo takim pas pune duke i parë ato si një mënyrë për të zgjeruar rrjetin e institucionit dhe për të ndërtuar një kulturë të përbashkët integriteti kundër korrupsionit. Organizimi i këtyre takimeve pas pune nga ky komponent është vetëm një nga mënyrat se si manifestohet bashkëpunimi profesional që është zhvilluar mes komponentit dhe KSHPK.


Darko Daçevski, Këshilltar në KSHPK që ka trajtuar shumë raste të raportuara dhe të inicuara nga KSHPK sheh si zgjidhje bashkimin e forcave për të rritur luftën kundër korrupsionit.

> “Këto takime joformale pas pune kundër korrupsionit më mundësojnë këmbimin e përvojave me profesionistë nga institucionet që i ngjasojnë institucionit tim, sidomos lidhur me procedurat operative dhe lidhur me rritjen e cilësisë së procedurave,” thotë Darkoja.

Kur krjimi i rrjeteve nxitet nga interesat e përbashkëta është më autentik-thotë Lena. Kur mendon më shumë për atë se ç’mund t’u japësh të tjerëve se sa ç’mund të marrësh nga ta, rrjetëzimi duket më pak promovim i vetvetes dhe më zemërgjerë – pra duket si diçka që ia vlen ta bëjmë. Ky është edhe qëllimi që ne kemi, dhe prandaj edhe përvoja në këto Takime pas Pune ka qenë mjaft interesante.

Deri tani në këto Takime joformale Pas pune kundër Korrupsionit kanë marrë pjesë profesionistë nga dhjetra organizata që nga Ministria e Brendshme e deri tek Shoqata për Revizion të Brendshëm.

Takimi i radhës Anti-korrupsion mbahet të mërkurën në 5 qershor me fillim në orën 15:40 në Bistro Komedija dhe gjithkush është i mirëseardhur.



Avancimi i rekomandimeve nga Raporti i Misionit të BE-së për shqyrtim kolegial: Rishikim i akteve nënligjore për të rritur efikasitetin e Këshillit Gjyqësor

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut me mbështetjen e projektit bëri edhe një hap shumë të rëndësishëm drejt forcimit të integritetit gjyqësor dhe transparencës së operacioneve duke bërë ndryshim dhe plotësim të akteve nënligjore. Kjo iniciativë si pjesë e një sërë reformave që dolën nga Raporti i Misionit të Shqyrtimit të BE-së në vitin 2023 shënoi kulmin e angazhimeve me disa punëtori që kishin për qëllim forcimin e kornizës gjyqësore në përputhje me standardet evropiane.

Kjo punëtori u mbajt në Mavrovë nga 15-17 prill dhe në të morën pjesë pesëmbëdhjetë administratorë nga Këshilli Gjyqësor. Kjo ishte punëtoria e tretë, që i pasoi tre takimeve të suksesshme në Veles dhe Shkup në janar dhe mars, dhe në të u vunë në fokus hollësitë komplekse që janë pjesë e operacioneve gjyqësore, sidomos forcimi i udhëzuesve proceduralë, vlerësimi dhe rangimi i gjykatësve dhe komunikimi strategjik. Ndër arritjet më të rëndësishme të punëtorisë është rishikimi i Rregullores së Këshillit dhe Rregullores për Rangim të Kandidatëve për Avancim në Gjykatë të një Rangu më të Lartë. Në fokusin e punëtorisë ishte rritja e cilësisë së mënyrës së menaxhimit me emërimet dhe vlerësimet në gjyqësor, si dhe rritja e cilësisë së udhëzuesve të funksionimit të Këshillit.





Me këto zhvillime pritet të rritet transparenca dhe efikasiteti i punës si dhe implementimi i rekomandimeve nga Raporti i vitit 2023 i Misionit të BE-së për recension kolegial që kanë të bëjnë me Këshillin. Me këto plotësime synohet të rritet cilësia e mënyrës së punës të Këshillit Gjyqësor, duke i bërë proceset vendimmarrëse më transparente, më të rrepta dhe më llogaridhënëse. Këto ndryshime përputhen me disa standarde evropiane, sidomos me ato që lidhen me përshpejtimin e procesit të vlerësimit të gjyqësorit dhe rritjen e transparencës së Këshillit.

AKTET NËNLIGJORE QË U NDRYSHUAN NGA KËSHILLI GJYQËSOR REPUBLIKAN I MAQEDONISË SË VERIUT

- **Rishqyrtim i Rregullores së Këshillit**
- **Rishqyrtim i Rregullores për Rangimin e Kandidatëve për Zgjedhje në Gjykatë të nivelit më të Lartë**
- **Forcim i Udhëzimeve Operative**



Këto përpjekje ambicioze të Këshillit Gjyqësor që nxiten nga qëllimet e përcaktuara në Raportin e Misionit të BE-së për recension kolegial dhe që mbështeten nga ekspertët brenda projektit tonë, janë simbol i një pune të palodhshme drejt një gjyqësori me menaxhim më transparent, më efikas, dhe më llogaridhënës në Maqedoninë e Veriut. Me këto reforma, Këshilli jo vetëm që rrit standardin e veprimit por edhe ushqen një mjedis besimi dhe integriteti, duke kontribuar kështu për një të ardhme ku sundimi i ligjit ka fjalën kryesore.





Kapja e suksesit:

Festë vizuele













Dialog për diskriminimin ndërsektorial dhe qasjen në drejtësi për gratë dhe vajzat rome

Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit (RoLaw) mbështeti organizimin e një debati publik mbi diskriminimin disa-shtresor dhe ndërseksional dhe qasjen në drejtësi me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat rome. Ky është takimi i parë i përbashkët i Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Disrkiminimi (KPMD) dhe Avokatit të Popullit, në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS).

Në këtë debat publik u bënë bashkë aktivistë, juristë dhe ekspertë që trajtojnë barazinë e të drejtave të grave dhe vajzave rome, si dhe barazinë e grupeve të tjera të margjinalizuara. Pjesëmarrësit analizuan kompleksitetin e burimit të pabarazisë dhe pengesave diskriminuese në qasje të drejtësisë për gratë dhe vajzat rome në shumëllojshmërinë e tyre, si dhe diskutuan mbi mënyrat dhe propozimet konkrete për tu zhdukur këto pengesa.



Diskutimi i gjallë dhe aktiv moderuar në mënyrë të shkëlqyer nga **Dragana Dërndarevska (KPMD)**, dëshmoi nevojën për ngjarje të këtilla publike ku palëve relevante iu jepet mundësia të ndajnë mendimet dhe përvojat që kanë mbi çështje të rëndësishme të barazisë dhe mosdiskriminimit, siç është qasja që kanë në drejtësi gratë dhe vajzat rome. Intervencat nga **Vaska Bajramovska Mustafa (nga Zyra e Avokatit të Popullit) dhe Mabera Kamberit (MPPS)** – gra të dalluara rome që me dekada merren me barazinë dhe të drejtat e grave dhe vajzave rome, pasuruan diskutimin, si edhe fjala hyrëse e **Igor Jadrovskit (KPMD)** ritheksuan angazhimin e pakontestueshëm për këtë çështje kaq të rëndësishme.



Në këtë ngjarje u pasqyrua angazhimi i vazhdueshëm i Projektit për të kontribuar maksimalisht në zbatimin e suksesshëm të Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtje, Promovim, dhe Përmbushje të të Drejtave të Njeriut për Gratë dhe Vajzat Rome (2022-2024). Kjo ngjarje përbën një hap të rëndësishëm në angazhimin e përbashkët për të promovuar drejtësinë ndërsektoriale—një aspiratë që ka fokusin në sigurimin e qasjes së barabartë në të drejta, mundësi, resurse dhe fuqi shoqërore për të gjithë, përfshirë këtu edhe gratë dhe vajzat rome.

Rezultatet e këtij diskutimi do të publikohen në një raport të veçantë për ngjarjen, dhe do të përdoren në procesin e hartimit të raportit të parë të përbashkët të Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit mbi çështjen e diskriminimit disa shtresor dhe ndërsektorial dhe qasjes në drejtësi me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat rome. Ky raport do të publikohet në vitin 2024.



BORKOWSKI Grzegorz

INTERVISTË

NJIHUNI ME EKIPIN

UDHËHEQËSI I KOMPONENTIT

“Ndërtimi i besimit si element i ndërtimit të sundimit të ligjit”

Prezantojmë ekipin: Përmes intervistave prezantojmë dhe ju njohim me anëtarët e ekipit të projektit „Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit".

Dr. Grzegorz BorkoVski, me mbi 17 vjet përvojë profesionale si gjykatës në Poloni në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Që nga viti 2018 ka qenë pjesë e EURALIUS V, një projekt i financuar nga BE-ja në Shqipëri, si udhëheqës komponente për të mbështetur Këshillin e Lartë Gjyqësor të sapoformuar, Këshillin e Lartë të Prokurorëve dhe institucione të tjera. Mes viteve 2015 dhe 2018 kishte funksionin e Udhëheqësit të Zyrës së Këshillit Nacional Gjyqësor në rangun e Nënsekretarit Shtetëror, kurse para kësaj për pesë vite me radhë ka punuar në Shkollën Nacionale të Gjyqësisë dhe Prokurorisë Publike si Udhëheqës i Sektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Poashtu, u zgjodh si Kryetari u parë i Bordit Këshillues të Këshillit të Evropës për Programin Evropian HELP dhe si gjykatës i kontraktuar polak punoi një vit si jurist procesues në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strazburg. Ka përvojë të gjatë si ekspert në projekte ndërkombëtare të fushës së gjyqësisë, si dhe me organizata ndërkombëtare siç janë OSBE-ODIHR, EJTN, CCJE, ENCJ, CoE, CEELI, ERA, USAID, UNICRI, UNODP etj. dhe është autor i shumë botimeve mbi çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.

Si udhëheqës i Komponentit 1 që ka në fokus gjyqësinë në Maqedoninë e Veriut brenda Projektit të BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit, si përkufizoni ju sundimin e ligjit?

Si gjykatës që jam, unë favorizoj praktikën, jo teorinë. Mund të citoj përkufizimin e ndonjë praktikuesi tjetër, siç është për shembull një gjykatës i Gjykatës Supreme të SHBA-së, i cili kur po diskutohej mbi paturpësinë dhe përkufizimin e pornografisë në vitet e 60-ta të shekullit të njëzetë, tha: “Nuk mund t’ju jap një përkufizim të saktë se ç’është por e dalloj kur e shoh.” Kjo mënyrë intuitive e përkufizimit vlen edhe për sundimin e ligjit. Pra, kur gjithkush respekton ligjin, jo vetëm njerëzit e zakonshëm por edhe funksionarët, prokurorët dhe kushdo që ka fuqi, atëherë e shohim që kemi të bëjmë me sundim të ligjit. Por për mua kjo nuk është e gjitha –ajo që është me rëndësi është besimi i popullit tek shteti dhe tek organet e shtetit.

Në qoftë se populli respekton kushtetutën dhe ligjet, jo vetëm për shkak të dënimeve të mundshme por për shkak të besimit që ka tek institucionet, atëherë kemi të bëjmë me sundim ligji. Qëllimi ynë është që të kemi gjyqësi që i kryen detyrat në mënyrë adekuate dhe transparente ngaqë kjo është mënyra e vetme për të fituar besimin e popullit. Në fund të fundit, populli do drejtësi dhe drejtësia duhet ofruar shpejt dhe në mënyrë transparente.

Sipas jush, cilat janë qëllimet apo prioritetet kryesore të Komponentit 1 në Maqedoninë e Veriut për të forcuar sundimin e ligjit brenda gjyqësisë për tri vitet e ardhshme, dhe si bëhet matja e ndikimit që do të kenë këto angazhime?

Suksesi mund të fitohet në shumë fusha dhe sfidat janë të shumta. Rritja e transparencës në sistemin e emërimit dhe avancimit të gjykatësve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane, rritja e përdorimit të teknologjisë informatike në gjyqësi dhe forcimi i pavarësisë të organeve gjyqësore dhe vetë gjykatësve janë çështjet thelbësore. Dhe ne po flasim jo vetëm për pavarësinë e gjyqësisë përballë forcave të tjera të pushtetit por edhe për pavarësine e gjykatësve si individë përballë kolegëve të tyre, përballë kryetarëve të gjykatave dhe si paradoks edhe për paravërsinë përballë shoqërisë në raste kur bëhet fjalë për lëndë të profilit të lartë kur gjykatësi duhet të ketë forcën për të qëndruar i paanshëm dhe i pavarur nga presionet e jashtme, gjë që është një sfidë në vete.



Sa i përket teknologjisë informatike në gjyqësor, është prioritet që të futet sistem i ri elektronik për menaxhimin me lëndën nëpër zyrat e prokurorisë, të rritet kapaciteti i IT-së dhe hartimi dhe miratimi i strategjisë së IT-së për sektorin e drejtësisë për vitet 2025-2029.

Një prioritet tjetër janë edhe relacionet mes gjyqësisë, prokurorisë dhe medieve. Po përpiqemi të arrijmë këtë qëllim, mes tjerash edhe duke mbështetur këshillin gjyqësor në aktivitetet për strategjinë e komunikimit të Këshillit dhe gjykatave. Për momentin, ky dokument është gati dhe pas konsultave me kryetarët e gjykatave duhet të miratohet brenda dy muajsh. Poashtu, po punojmë në hartimin e strategjisë së komunikimit për Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe prokurorive.

Në përgjithësi, në fokus kemi këto fusha që i shohim si qëllime kryesore: rritja e aftësive të gjykatësve, prokurorëve dhe kandidatëve për këto profesione, si dhe anëtarëve të këshillave gjyqësorë dhe prokurorialë, zbatimi i teknologjive më të mira në gjyqësor, forcimi i pavarësisë dhe transparencës për çdo organ gjyqësor dhe mbështetja e Ministrisë së Drejtësisë në zbatimin e Strategjisë Gjyqësore. Për të matur ndikimin do të monitorojmë nga afër zhvillimet, do të marrim informacion kthyes nga komuniteti juridik dhe do i kushtojmë rëndësi të veçantë perceptimit të besimit që populli ka tek sistemi gjyqësor. Me fjalë tjera, do të arrijmë sukses në qoftë se pas zbatimit të projektit tonë sondazhet rezultojnë me rritje të besimit tek gjyqësia.

A mund të ndani shembuj nga iniciativa apo reforma të suksesshme që janë zbatuar nga Komponenti 1 që kanë kontribuar në rritjen e efektivitetit të gjyqësisë?

Do të thoja që suksesi kryesor ka qenë mbështetja gjatë hartimit dhe miratimit të Strategjisë Zhvillimore të Gjyqësorit nga Ministria e Drejtësisë. Që në fillim të projektit kemi mbështetur grupin e punës udhëhequr nga Prof. Kambovski për të hartuar strategjinë e gjyqësorit ku pasqyrohen standardet e BE-së, bashkë me vlerësimin e ndikimit dhe instrumentet e monitorimit. Ishte një sfidë e madhe të mblidhen të dhënat relevante nga të gjitha palët me interes dhe i gjithë ekipi ishte pjesë aktive në këtë detyrë. Suksesi më i madh ishte që ia dolëm të kemi gati dokumentin deri në fund të vitit që lamë pas dhe Strategjia Zhvillimore për Gjyqësorin për vitet 2024-2028 u miratua ne dhjetor të vitit 2023.

Për momentin po mbështesim Ministrinë e Drejtësisë gjatë monitorimit të zbatimit të kësaj Strategjie, që në qoftë se bëhet sipas standardeve evropiane do të rrisë efektivitetin e funksionimit të sistemit të drejtësisë në tërësi.

Një shembull tjetër i suksesit për sa i përket gjyqësorit është edhe mbështetja nga Këshilli Gjyqësor për hartim të planit të veprimit për zbatim të rekomandimeve nga misioni i kontrollit nga kolegët (peer review). Ky plan veprimi u miratua si dokument zyrtar nga Këshilli Gjyqësor.

Poashtu, gjatë një takimi tre ditor me anëtarët e Këshillit Gjyqësor shqyrtuam aktet nënligjore përfshirë këtu edhe rregulloret dhe vlerësimin e performancës së gjykatësve që kërkojnë avancim; të gjitha këto janë elemente që vijnë nga rekomandimet e misionit të kontrollit nga kolegët.

U prezantua raporti mbi procedurat diciplinore përgatitur nga ekspertët tanë gjatë një diskutimi mbi procedurat diciplinore në Zyrën e Prokurorisë Publike dhe u hap diskutimi për nevojat për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për Procedura Diciplinore.



Me përvojën profesionale që keni si gjykatës në Poloni, dhe lidhur me angazhimet e fundit të suksesshme për të mbrojtur pavarësinë në gjyqësor, a mund të ndani ndonjë informacion praktik dhe ndonjë rekomandim që bazohet në përvojën tuaj që mund t'u shërbejë gjykatësve për të forcuar sistemin e përgjithshëm ligjor në vendin tonë?

Kur filloi e ashtuquajtura ''reformë'' në gjyqësi në Poloni (për fat të keq nuk ishte ajo që pritet kur thuhet fjala ''reformë"), ne si gjykatës e kuptuam që më e rëndësishmja që gjykatësit të jenë të pavarur është mbështetja nga opinioni, pra mbështetja nga populli si dhe nga kolegët evropianë. Unë jam gjykatës në Poloni dhe jam anëtar i Shoqatës së Gjykatësve Iustitia por poashtu kam qenë Udhëheqës i Zyrës së Këshillit Nacional të Gjyqësorit kur filloi e gjithë kjo, pra kam qenë pjesë e drejtpërdrejtë e angazhimeve që të ruhet pavarësia në gjyqësor. Ajo që kemi mësuar si gjykatës është që duhet patjetër të informosh opinionin, nuk duhet të mjaftojë vetëm shpjegimi që ofrohet nga aktgjykimet – siç na është thënë gjatë trajnimeve fillestare. Në Poloni e kuptuam që kjo qasje është e gabuar.

Besimi i shoqërisë është thelbësor që gjyqësori të ruajë pavarësinë dhe të mbrojë demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykatësit duhet ta kuptojnë rolin e tyre si shërbyes të shoqërisë dhe të komunikojnë atë në mënyrë efektive. Sipas standardeve evropiane që janë hartuar jo vetëm nga aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut por edhe sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias por edhe opinioneve nga CCJE, gjykatësit jo vetëm që kanë të drejtë të ngrejnë zërin kur bëhet fjalë për diskutim publik mbi reformat në drejtësi – po ata e kanë për detyrë të bëjnë këtë.

Pikërisht këtë bëri Iustitia, ngaqë jo vetëm që mbështeti gjykatësit që u sulmuan nga forcat e tjera të pushtetit, që u suspenduan apo që ishin objekt i procedurave diciplinore; por Iustitia ishte poashtu shumë e zëshme edhe në debatin public mbi programet gjyqësore dhe edukative. Shumë gjykatës, prokurorë dhe avokatë polakë ndoqën trajnime (edukimin primar dhe sekondar) dhe mësime mbi Kushtetutën, rëndësinë që ka zbatimi i ligji, cili duhet të jetë roli i gjykatësve dhe prokurorëve, dhe më e rëndësishmja, rëndësia që ka Kushtetuta. Dikush mund të thotë që ky përbën një investim tek të rinjtë, tek gjeneratat që vijnë pas. Për mendimin tim kjo përvojë mund të jetë shumë e vlefshme për shoqatat e gjykatësve dhe prokurorëve në Maqedoninë e Veriut.

Shumë njerëz në Poloni dolën në rrugë për të protestuar para gjykatave për mbrojtje të pavarësisë së gjyqësorit. Poashtu, na mbështetën edhe gjykatësit nga Evropa, jo vetëm nga institucionet siç janë CCJE, ENCJ apo EAJ, që dhanë deklarata të shumta por edhe duke marrë pjesë në “Marshi i 1000 togave” në janar të vitit 2020 ku morën pjesë mbi 30 000 njerëz në Varshavë.

Në temperatura të ulëta, gjykatës nga shumë vende të Evropës marshuan së bashku nëpër rrugët e Varshavës duke pasur veshur togat e gjykatësve (gjë që nuk praktikohet jashtë seancave të gjyqit), duke protestuar kështu kundër përpjekjeve për shkelje të pavarësisë së gjyqësorit.

Ishte një moment që më emocionoi shumë, gjatë një demonstrate tjetër para Gjykatës Supreme, kur organet u përpoqën të ulin moshën e pensionimit për gjykatësit e Gjykatës Supreme në Poloni, për të hequr qafe pjesën më të madhe të tyre. Isha atje me miqtë e mi dhe e pashë që dikush kishte vendosur një pankartë të madhe tek ndërtesa e Gjykatës ku shkruhej: “Kjo është gjykata jonë”. Ishte ky një moment i mrekullueshëm dhe u ndjeva shumë krenar me bashkëqytetarët e mi polakë ngaqë e kuptova aty që si shoqëri kemi arritur në stadin ku sundimin e ligjit e kemi në zemër. Unë besoj fortë që si përvoja ime ashtu edhe e kolegëve të mi nga Komponenti 1 dhe puna që ne bëjmë këtu do ndihmojë në ndërtimin dhe ruajtjen e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut.

MAJ-KORRIK 2024

KALENDARI NGJARJET E ARDHSHME

20 MAJ – **23 MAJ**

Punëtori për hartimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për procedura diciplinore kundër prokurorëve publikë

Komponenti 1

05 QERSHOR

Takime pas Pune Kundër Korrupsionit

Komedi Bistro

Komponenti 3

30 MAJ – **31 MAJ**

Trajnim për teknikat e intervistimit dhe komunikimit gjatë krizave për grupin e punës të PR nga shërbimi i provës

Velesi

Komponenti 4

29 MAJ

Ndriçimi i hijeve: Hetimi i larjes së parave dhe prezantimi i praktikave më të mira në Republikën e Sllovenisë

Komponenti 2

03 KORRIK

Biseda Barazie për arsimin gjithëpërfshirës organizuar me CPPD

Shkupi

Komponenti 4





Kapja e suksesit:

Festë vizuele











Periudha e raportimit: 08 shkurt - 07 maj 2024
Redaktoi: Kristina Vesiq, Zyrtare e Vizibilitetit
Data e botimit: Maj 2024
Adresa: Vasil Gllavinov 14, Shkup 1000
E-mail: kristina.vesikj@rolaw.mk
Botimi: Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit, Raporti i Tremujorit të Rretë, Lajme të mira nga sundimi i ligjit

Financuar nga Bashkimi Evropian